



PRILL 2018

## Përditësim mbi procesin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe

Arrestimi i Marko Gjuriqit, shefit të zyrës së Beogradit “për Kosovën dhe Metohinë” dhe Këshilltarit të Presidentit të Serbisë për Politikë të Jashtme, ka çuar në rritjen e tensioneve dhe madje mund të çojë në pengimin e punës së Qeverisë së Kosovës. Gjuriq, njëri nga negociatorët në dialogun Prishtinë – Beograd, u arrestua gjatë pjesëmarrjes në një tryezë të rrumbullakët publike në Mitrovicë lidhur me “dialogun e brendshëm mbi çështjen e Kosovës”. Një pjesë e madhe e tensioneve themelore është fakti që Qeveria e Kosovës nuk është në gjendje të formojë Asociacionin e Komunave me shumicë serbe (në tekstin e mëtejshëm *Asociacioni*). Lista Serbe, partia e cila përfaqëson kryesisht interesat e serbëve të Kosovës, ka dhënë ultimatum rreth krijimit të Asociacionit. Lista Serbe vendosi të bëhej pjesë e Qeverisë së Kosovës në shtator 2017, në radhë të parë për të formuar *Asociacionin* sa më shpejt që të ishte e mundur.

Kjo parti aktualisht mban tri poste ministrore dhe një të Zëvendëskryeministrit, të cilat i mbajnë Dallibor Jevtiq (Zëvendëskryeministër dhe Ministër për Kthim dhe Komunitete), Ivan Teodosijeviq (Ministër i Pushtetit Lokal) dhe Nenad Rikalo (Ministër i Bujqësisë).<sup>1</sup> Më 28 mars, Kryetarët dhe këshilltarët e dhjetë komunave të banuara me shumicë serbe në Kosovë, zhvilluan një takim nga i cili dolën disa përfundime.<sup>2</sup> Komunitatet me shumicë serbe njoftuan se do të fillojnë formimin e *Asociacionit* në mënyrë të pavarur nga Prishtina nëse politikanët e Kosovës nuk janë të gatshëm të fillojnë të punojnë për këtë brenda tri javëve të ardhshme. Përveç kësaj, që njerëzit përgjegjës për arrestimin e Marko Gjuriqit të ndiqen penalisht, që

---

<sup>1</sup> Arben Qirezi, ‘Serbian List’s Threats Could Rebound on Kosovo Serbs’, ueb-faqja e *Balkan Insight*, 29.03.2018, <http://www.balkaninsight.com/en/article/serbian-list-s-threats-could-rebound-on-kosovo-serbs-03-29-2018> (29.03.2018).

<sup>2</sup> Muhamer Pajaziti, ‘Serbian List issues an ultimatum about the creation of the Association of Serbian Communes’, ueb-faqja e *IBNA*, 28.03.2018, <http://www.balkan.eu.com/serbian-list-issues-an-ultimatum-about-the-creation-of-the-association-of-serbian-communes/> (28.03.2018).

Ministri i Brendshëm Flamur Sefaj të shkarkohet dhe që KFOR-i dhe EULEX-i të shtojnë praninë e tyre për të mbrojtur serbët.<sup>3</sup>

Presidenti Thaçi dhe Kryeministri Haradinaj veçse kanë deklaruar se, sipas tyre, ultimatumit është qasje e gabuar.<sup>4</sup> Nga ana tjetër, pak më shumë se një javë pasi Lista Serbe paraqiti kërkesat e tyre, Thaçi dhe Haradinaj rifilluan përpjekjet e tyre për zbatimin e marrëveshjes duke riaktivizuar ekipin menaxhues të ngarkuar për hartimin e statutit të Asociacionit.<sup>5</sup> Ky veprim u mirëprit nga Zyra e BE-së në Kosovë, e cila deklaroi se marrëveshja për Asociacionin duhet të zbatohet 'pa vonesa të mëtejshme'.<sup>6</sup> Megjithatë, lista serbe ende nuk është e kënaqur, sepse ata e konsiderojnë 'të papranueshme' iniciimin e statutit bazuar në Kushtetutën e Kosovës.<sup>7</sup> Ideja e themelimit të *Asociacionit* ka qenë dhe ende mbetet pjesë e dialogut të Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe është menduar si një element i procesit të 'normalizimit të marrëdhënieve', i cili, përmes marrëveshjes së nënshkruar në prill të vitit 2013.<sup>8</sup> Në verën e vitit 2016, ECMI Kosova kishte publikuar një raport me titullin *Asociacioni i Komunave me shumicë serbe: ndërprerja e ngërçit*.<sup>9</sup> Ky raport i ECMI-së kishte për qëllim të kontribuonte në zhvillimin e një projekt-statuti për *Asociacionin* duke ofruar rekomandime konkrete. Në këtë analizë të shkurtër politikash analizojmë zhvillimet e fundit dhe hapat pasues që duhet ndjekur në lidhje me dialogun rreth *Asociacionit*.

### Ndërprerja e ngërçit

Analiza *Ndërprerja e ngërçit* fokusohet në disa fusha, si bashkëpunimi ndër-komunal në Kosovë dhe korniza ligjore që rregullon këtë. Përveç kësaj, ajo fokusohet edhe në strukturën ekzistuese dhe

---

<sup>3</sup>UNMIK, 'Sesioni i 10 komunave me shumicë serbe në veri të Mitrovicës - 3 përfundime të miratuara', ueb-faqja e UNMIK-ut, 28.03.2018, <http://media.unmikonline.org/?p=82782> (29.03.2018).

<sup>4</sup>N.N., 'Nuk ka këmbim të territorit apo ndarje të Kosovës, thotë kryeministri Haradinaj', 28.03.2018, ueb-faqja e *Gazetës Express*, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/no-exchange-of-territory-or-partition-of-kosovo-says-pm-haradinaj-173906/> (29.03.2018).

<sup>5</sup>N.N., 'Kosova rifillon punën për themelimin e Bashkësisë së Komunave Serbe', 04-04-2018, website *Gazeta Express*, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/kosovo-recommence-work-on-serbian-municipal-association-173941/> (06-04-2018).

<sup>6</sup>N.N., 'Eichhorst visiting Pristina: EU welcomes announcement on start drafting Statute of the Association/Community', 05-04-2018, website *EU Office in Kosovo*, [https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/42501/eichhorst-visiting-pristina-eu-welcomes-announcement-start-drafting-statute\\_en](https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/42501/eichhorst-visiting-pristina-eu-welcomes-announcement-start-drafting-statute_en) (06-04-2018).

<sup>7</sup>N.N., 'Lista serbe kundërshton nismën e Qeverisë së Kosovës për Asociacionin', 05-04-2018, website *Gazeta Express*, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/srpska-list-opposes-kosovo-government-initiative-on-association-173949/> (06-04-2018).

<sup>8</sup>EEAS, 'Association/Community of Serb majority municipalities in Kosovo – general principles/main elements', ueb-faqja e *Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS)*, [http://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825\\_02\\_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf).

<sup>9</sup>Adrian Zeqiri, Pieter Troch dhe Trim Kabashi, *Asociacioni i komunave me shumicë serbe: ndërprerja e ngërçit* (2016).

funksionimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.<sup>10</sup>Më tej, aty janë shpjeguar kompetencat e *Asociacionit* dhe se si do të dallojnë ato nga Asociacioni ekzistues i Komunave të Kosovës. Ajo që bëhej e qartë aty është se komunat me shumicë serbe do të kenë autonomi institucionale dhe koordinimin në disa fusha, si arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, kulturë, zhvillim ekonomik lokal, si dhe planifikim rural dhe urban. Ky raport i ECMI-së kishte ngritur shqetësime në lidhje me karakterin mono-etnik të Asociacionit, pasi që në të gjitha komunat me shumicë serbe jetojnë edhe komunitete të tjera, si shqiptarë, boshnjakë, romë dhe goranë. Në analizën *Ndërprerja e ngërçit* thuhej se “*Asociacioni* nuk mund të reduktohet në një organ që përfaqëson vetëm interesat e komunitetit serb të Kosovës” dhe se “*Asociacioni* duhet të marrë pjesë në mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në nivelin qendror.”<sup>11</sup>

Ajo që e ka bërë Asociacionin diçka shprehimisht të rëndësishëm për serbët që jetojnë në këto komuna është se ai do të mundësojë ndërveprim më të drejtpërdrejtë me Republikën e Serbisë, si dhe mbështetje financiare dhe teknike nga ajo. Ndonëse kjo shihej si mënyrë për të rregulluar marrëdhëniet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në analizën *Ndërprerja e ngërçit* thuhej se kjo duhet të bëhet tërësisht me anë të kornizës ekzistuese ligjore të Kosovës.<sup>12</sup> Së pari, duhet hartuar një akt nënligjor që përcakton mundësitë dhe kufizimet ligjore për bashkëpunimin ndër-komunal ndërmjet komunave me shumicë serbe. Së dyti, përfaqësuesit e komunave me shumicë serbe duhet të hartojnë një ose më shumë draft-Statute për bashkëpunimin ndër-komunal brenda konturave të kësaj kornize, të përkufizuar me këtë akt nënligjor. Kjo, siç thuhej në këtë raport, duhet të bëhet përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, pasi që vendimet pasuese të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të realizohen nëpërmjet krijimit të vetëm një mekanizmi, pasi që kjo do të pengonte funksionimin e rendit juridik të Kosovës. Në vend të kësaj, në analizën *Ndërprerja e ngërçit* ishte sugjeruar që të krijoheshin disa mekanizma të cilët, si të tërë, do të përmbushnin shumicën e kërkesave të komunitetit serb.<sup>13</sup>

Çështja qendrore e themelimit të *Asociacionit* është se nuk mund të integrojë në një institucion të gjitha marrëveshjet dhe dispozitat, të parat, të dytat dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese mbi Asociacionin, pa penguar funksionimin e rendit kushtetues dhe ligjor të Kosovës.<sup>14</sup>Përveç nëse do të bëheshin ndryshime

---

<sup>10</sup>Ibid, 13-15.

<sup>11</sup>Ibid, 35.

<sup>12</sup>Ibid, 37-38.

<sup>13</sup>Ibid, 6-7.

<sup>14</sup>Për më tepër informata rreth këtyre vendimeve, shihni Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosova), [Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Asociacionin e komunave me shumicë serbe](#) (28 janar 2016).

të mëdha kushtetuese, nuk ka mundësi që vetëm një institucion të përmbajë të gjitha elementet e marrëveshjeve të cekura më lart. Prandaj, në këtë raport thuhet se kjo mund të arrihet vetëm përmes krijimit të disa institucioneve që bashkërisht do të adresojnë të gjitha dispozitat e marrëveshjeve deri më tani lidhur me marrëveshjen për asociacionin, dhe, ç'është më e rëndësishmja, do të funksionojnë në kuadër të kornizës ekzistuese kushtetuese dhe ligjore të Kosovës. Në këtë raport propozohet krijimi i një asociacioni i cili do të veprojë si organizatë jo-qeveritare dhe do të jetë në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.<sup>15</sup>Përveç kësaj, duhet të themelohen të paktën tri 'institucione të përbashkëta publike', në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal.<sup>16</sup>Asociacioni i krijuar në këtë mënyrë do të ketë funksion të mbikëqyrjes politike dhe koordinimit, por jo autoritet mbi institucionet e përbashkëta publike. Edhe pse OJQ-ja do të koordinojë udhëzimet e ndryshme, këto institucione do të funksionojnë në mënyrë të pavarur.

Kjo nënkupton se *Asociacioni*, në kornizat e tij, do të krijohej si ushtrim në bashkëpunim ndër-komunal, brenda kornizës ligjore të Kosovës, që mundëson vetëqeverisje të gjerë. Nëpërmjet krijimit të tri 'institucioneve të përbashkëta publike', siç parashihet në nenin 9 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, do të përmbushen shumica e kërkesave të komunitetit serb.<sup>17</sup> Këto institucione publike do të ushtrojnë së bashku kompetencat komunale në fusha të veçanta si arsimimi në gjuhën serbe, kujdesi shëndetësor e mirëqenia sociale, dhe kultura. Nëpërmjet krijimit të këtyre mekanizmave, do të përmbushen dispozitat e së parë, të dytë dhe të vendimit të gjykatës kushtetuese në bashkëpunim. Dhe, ç'është më e rëndësishmja, ky procesi nuk do të pengojë funksionimin e rendit kushtetues dhe ligjor të Kosovës.<sup>18</sup>Kanë kaluar gati dy vjet që nga publikimi i analizës *Ndërprerja e ngërçit*. Më tej, kanë kaluar pesë vjet nga marrëveshja e parë dhe 3 vjet nga marrëveshja e dytë pasuese mbi parimet e përgjithshme/elementet kryesore të *Asociacionit*. Tani jemi në mars 2018, ngërçi akoma nuk është tejkaluar, dhe marrëveshja mbetet e pazbatuar. Gjendja nuk ka ndryshuar, edhe pse shumica e marrëveshjeve të tjera të Brukselit janë zbatuar dhe të tjerat janë tashmë në zbatim e sipër.<sup>19</sup> Në paragrafët në vijim të kësaj analize hidhet një sy mbi atë se çfarë ka shkaktuar këtë ngecje.

---

<sup>15</sup>[Ligji \(nr. 03/L-040\) për vetëqeverisjen lokale](#) (20 shkurt 2008) dhe [Ligji \(nr. 04/L-057\) mbi Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare](#) (29 gusht 2011).

<sup>16</sup>[Ligji \(nr. 04/L-010\) për Bashkëpunim Ndërkomunal](#) (21 korrik 2011).

<sup>17</sup>Ibid, Art. 9.

<sup>18</sup>Zeqiri et al, *Ndërprerja e ngërçit*, 6-7.

<sup>19</sup>Zyra e Kryeministrit të Kosovës, 'Brussels Agreements Implementation State of Play', website *Kryeministri*, 25-11-2016, <http://www.kryeministri->

## Zhvillimet në kontestin që ka të bëjë me dialogun për Asociacionin

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016, emërimi i një ekipi menaxhues që ishte dashur të hartonte statutin e *Asociacionit* kishte shkaktuar mosmarrëveshje gjatë diskutimeve në Bruksel.<sup>20</sup> Përfaqësuesit kosovarë kishin akuzuar Serbinë për krijimin e një ekipi menaxhues pa u konsultuar me ta. Si rrjedhojë, duhet të emërohej një ekip i ri, me pëlqimin e të gjitha palëve, i cili do të mund të vazhdonte të punojnë në projektstatutin e Asociacionit.<sup>21</sup> Që nga ajo kohë nuk ka pasur ndonjë përparim, për shkak të disa ndodhive. Veprimet e fundit nga të dyja palët kanë krijuar dyshime në lidhje me zhvillimet për stabilizimin e gjendjes dhe kanë pasur ndikim negativ në zbatimin e marrëveshjeve. Dukej se të dy palët kishin këndvështrime të ndryshme rreth asaj se si duhet të dukej stabilizimi i gjendjes, gjë që ka rezultuar në tensione të reja. Për shembull, në tetor 2016 Qeveria e Kosovës kishte forcuar autoritetin e saj në atë zonë përmes marrjes së pronësisë së mbi 80% të minierave të Trepçës në kufirin administrativ në mes të pjesës veriore dhe jugore të Mitrovicës.<sup>22</sup> Përveç kësaj, nga muaji mars 2017 e këndej, Presidenti i Kosovës Thaçi ka deklaruar vazhdimisht se ai ka për qëllim të formojë Ushtrinë e parë të Kosovës.<sup>23</sup> NATO ka deklaruar se një ide e tillë e njëanshme është 'e padobishme', pasi që kjo duhet të bëhet në marrëveshje me komunitetin serb të Kosovës dhe se do të kërkojë ndryshime kushtetuese.<sup>24</sup> Nga ana tjetër, ShBA ka njoftuar kohët e fundit se mbështet krijimin një ushtrie të Kosovës.<sup>25</sup>

Këto veprime nuk janë mirëpritur nga Serbia, e sidomos jo nga komuniteti serb që jeton në Mitrovicën e Veriut. Nga ana tjetër, as autoritetet serbe nuk kanë qenë plotësisht konstruktive. Për shembull, ata janë përpjekur të ndërtojnë një mur betoni pranë anës së tyre të urës që lidh pjesën jugore me atë veriore të

---

[ks.net/repository/docs/Kosovo\\_Report\\_on\\_State\\_of\\_Play\\_in\\_implementation\\_of\\_the\\_Brussels\\_Agreements\\_25\\_November\\_2016.pdf](https://ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_State_of_Play_in_implementation_of_the_Brussels_Agreements_25_November_2016.pdf) (05.03.2018).

<sup>20</sup>N.N., 'Community of Serb Municipalities steering team unveiled', ueb-faqja e B92, 08.09.2016, [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2016&mm=09&dd=08&nav\\_id=99146](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2016&mm=09&dd=08&nav_id=99146) (06.03.2018).

<sup>21</sup>Zyra e Kryeministrit të Kosovës, 'Statement by Minister for Dialogue, Edita Tahiri', ueb-faqja *Kryeministri*, 08.09.2016, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,6132> (06.03.2018).

<sup>22</sup>Fatos Bytyci, 'Kosovo government takes control of Trepca mine, Serbs protest', ueb-faqja e *Reuters*, 08.10.2016, <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-mines/kosovo-government-takes-control-of-trepca-mine-serbs-protest-idUSKCN12808T> (28.03.2018).

<sup>23</sup>EUNPACK, *The EU's Crisis Management in the Kosovo-Serbia crises* (2017) 30.

<sup>24</sup>Fatos Bytyci dhe Robin Emmott, 'NATO, U.S. slap Kosovo's move to create national army', ueb-faqja e *Reuters*, 08.03.2018, <https://www.reuters.com/article/us-kosovo-army/nato-u-s-slap-kosovos-move-to-create-national-army-idUSKBN16F1GE> (30.03.2018).

<sup>25</sup>Lauren von Bernuth, 'The US Wants to Help form first ever Kosovo Army', ueb-faqja *Citizen Truth*, 27.03.2018, <https://citizentruth.org/kosovo-army/> (28.03.2018).

Mitrovicës, në fund të vitit 2016.<sup>26</sup> Për më tepër, në janar 2017, një tren me piktura që simbolizonin atë të flamurit serb, simbole fetare ortodokse dhe parullën “Kosova është Serbi”, në 21 gjuhë të ndryshme, ishte dërguar nga Serbia për në Mitrovicë.<sup>27</sup> As indikacionet për të mbajtur zgjedhjet presidenciale të Serbisë, të prillit 2017, në pjesën veriore të Kosovës nuk kanë ndihmuar në normalizimin e marrëdhënieve.<sup>28</sup> Asnjëri nga këto veprime kanë kontribuar në përparime në integrimin e serbëve të Kosovës dhe komunave veriore në sistemin kosovar, por më tepër kanë destabilizuar gjuhën e përbashkët të krijuar mes palëve. Për më tepër, autoritetet kosovare kanë këmbëngulur qëpara se të krijohet Asociacioni sëpari të zbatohen marrëveshjet e tjera, si ajo për kodin telefonik shtetëror për Kosovën, si dhe shpërbërja e strukturave paralele të Serbisë brenda Kosovës.<sup>29</sup>

### Demarkacioni i kufirit dhe integrimi në BE

Kosova mbajti zgjedhjet parlamentare gjatë verës së vitit 2017 dhe zgjedhjet lokale në tetor të të njëjtit vit.<sup>30</sup> Që nga fundi i vitit 2017, diskutimet në Kuvend janë fokusuar kryesisht në ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi.<sup>31</sup> Bashkësia ndërkombëtare, d.m.th. përfaqësuesit e BE-së dhe ShBA-së, kanë qenë mjaft të zëshëm duke u kërkuar politikanëve të Kosovës të votojnë për ratifikimin demarkacionit, pasi që është një nga kërkesat e fundit të mbetura për Kosovën për të marrë liberalizimin e vizave.<sup>32</sup> Lista Serbe ka luajtur një rol të theksuar në bllokimin e marrëveshjes së demarkacionit. Për ta, marrëveshja për demarkacionin e kufirit ishte më pak e rëndësishme se Asociacioni, gjë që zëdhënësi Igor

---

<sup>26</sup>Die Morina, ‘Kosovo Bans Building of Serb Wall in Mitrovica’, ueb-faqja e *BIRN-it*, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-serbs-build-a-wall-in-northern-divided-city-12-08-2016> (28.03.2018).

<sup>27</sup>N.N., ‘Serbian Nationalist Train Halts at Border With Kosovo’, ueb-faqja e *The New York Times*, 14.01.2017, <https://www.nytimes.com/2017/01/14/world/europe/kosovo-serbia-train.html> (28.03.2018).

<sup>28</sup>EUNPACK, ‘The EU’s Crisis Management in the Kosovo-Serbia crises’, ueb-faqja e *EUNPACK*, 31.03.2017, <http://www.eunpack.eu/sites/default/files/deliverables/D5.1%20The%20EU%E2%80%98s%20Crisis%20Management%20in%20the%20Kosovo-Serbia%20crises.pdf> (05.03.2018).

<sup>29</sup>Zyra e Kryeministrit të Kosovës, ‘Brussels Agreements Implementation State of Play’, ueb-faqja *Kryeministri*, 25.11.2016, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo\\_Report\\_on\\_State\\_of\\_Play\\_in\\_implementation\\_of\\_the\\_Brussels\\_Agreements\\_25\\_November\\_2016.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_State_of_Play_in_implementation_of_the_Brussels_Agreements_25_November_2016.pdf) (05.03.2018).

<sup>30</sup>BIRN, ‘Kosovo Ex-Warriors and Vetevendosje Celebrate Elections Results’, ueb-faqja e *Balkan Insight*, 12.06.2017, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-ex-warriors-and-vetevendosje-celebrate-elections-results-06-12-2017> (05.03.2018) dhe *GazetaExpress*, ‘All You Need to Know about Kosovo Local Elections’, ueb-faqja e *Gazetës Express*, 23.10.2017, <http://www.gazetaexpress.com/en/news/all-you-need-to-know-about-kosovo-local-election-173127/> (05.03.2018).

<sup>31</sup>Fjona Krasniqi, ‘The Kosovo-Montenegro Border Agreement: What You Need to Know’, ueb-faqja e *Open Democracy*, 23.02.2017, <https://www.opendemocracy.net/can-europe-make-it/fjona-krasniqi/kosovo-montenegro-border-agreement-what-you-need-to-know> (06.03.2018).

<sup>32</sup>Balkan Insider, ‘Juncker Urges Kosovo to Ratify Demarcation’, ueb-faqja e *Balkan Insider*, 01.03.2018, <https://www.balkaninsider.com/juncker-urges-kosovo-to-ratify-demarcation/> (05.03.2018).

Simiq e kishte deklaruar disa herë: “Kur flasim për obligimet që ka marrë përsipër Kosova ndaj komunitetit ndërkombëtar, krijimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe është prioritet për ne.”<sup>33</sup>Tani që më në fund marrëveshja për demarkacionin e kufirit është ratifikuar, Asociacioni është rikthyer në diskutime.

Strategjia e re e Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor përmend disa probleme që duhet të trajtohen nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për t’u ofruar mundësinë e anëtarësimit të ardhshëm në BE.<sup>34</sup>Komisioni Evropian deklaron qartë se e ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është brenda BE-së. Megjithatë, ai gjithashtu thekson se “në mënyrë që vendet të përmbushin të gjitha kushtet për anëtarësim dhe të forcojnë demokracinë, edhe më tej nevojiten reforma gjithëpërfshirëse dhe bindëse në fusha të rëndësishme, sidomos në sundimin e ligjit, konkurrueshmëri, si dhe në bashkëpunimin rajonal dhe pajtim.”<sup>35</sup>Për sa i përket sundimit të ligjit, të gjitha vendet duhet të tregojë rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe për sistemet e dobëta gjyqësore. Të drejtat themelore janë të përfshira mjaft mirë në dokumentet zyrtare, por në shkallë të gjerë mungon zbatimieftiv në praktikë.Përveç kësaj, të gjitha vendet duhet të sigurojnë dhe të sigurojnë qeverisjen e mirë dhe institucione funksionale demokratike, prandaj kjo strategji bën thirrje për reforma në administratën publike.<sup>36</sup> Qeveria e Kosovës akoma nuk ka dalë me një plan të qartë për procesin për hartimin e një statuti për Asociacionin. Ky proces është kompleks dhe do të kërkojëkohë dhe konsultim me të gjitha palët e interesuara. Për këtë arsye, ultimatumi i vendosur nga Lista Serbe nuk përbënjë zhvillim konstruktiv, pasi qëkjo çështje shumë e rëndësishme duhet të trajtohet në mënyrë të pjekur, me përfshirjen e të gjitha palëve.

#### Rreth ECMI Kosovës

**ECMI Kosova është organizata kryesorejoqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.**

<sup>33</sup>N.N., ‘Lista Serbe nuk ka qëndrim në lidhje me marrëveshjen për shënjimin e kufirit ’, ueb-faqja RTK Live, <https://www.rtklive.com/en/news-single.php?ID=10660> (28-03-2018).

<sup>34</sup>N.N., ‘Strategy for the Western Balkans: EU sets out new flagship initiatives and support for the reform-driven region’, ueb-faqja e Komisionit Evropian, 06.02.2018, [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-18-561\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-18-561_en.htm) (06.03.2018).

<sup>35</sup>Komisioni Evropian, *A Credible Enlargement Perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans* (2018) 3.

<sup>36</sup>Ibid, 4-5.